



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 nëntor 2021
Nr. ref.:RK 1887/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI107/21

Parashtrues

Ramiz Hoti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme,
Rev. Nr.138/2020, të 21 janarit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ramiz Hoti, me vendbanim në fshatin Zajm, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. Nr.138/2020, të 21 janarit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin Ac. Nr. 2830/17 të 16 dhjetorit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin, C. Nr. 336/16, të 27 marsit 2017 të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 16 shkurt 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 24 [Barazia para Ligjit] dhe 49 [E Drejta për Punë dhe Ushtrim të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 4 qershor 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
7. Më 4 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
8. Më 15 korrik 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Të njëjtën ditë, Gjykata i dorëzoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe Policisë së Kosovës.
10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 8 shtator 2021, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës shkresën për dorëzimin e kopjes së revizionit të parashtruar në Gjykatën Supreme.
12. Më 16 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kopjen e kërkuar të revizionit.
13. Më 21 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës nga 18 dhjetori 2000 deri më 7 shtator 2012 kishte qenë i punësuar si zyrtar policor në Policinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Policia e Kosovës).
15. Më 7 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës kishte dhënë dorëheqje vullnetare si zyrtar policor i Policisë së Kosovës.
16. Në kohën e dorëheqjes së parashtruesit të kërkesës nga pozita e zyrtarit policor të Policisë, kishte qenë në fuqi Udhëzimi Administrativ nr. 12/2009 i Policisë së Kosovës për Procedurat e Ripunësimit për Zyrtarët Policorë, i nënshkruar më 10 prill 2010, i cili përcaktonte që zyrtarët policorë që kishin dhënë dorëheqje vullnetare me qëndrim të mirë, apo janë shkarkuar apo liruar si rezultat i riorganizimit apo reduktimit të Policisë së Kosovës kanë të drejtë për t'u ripunësuar në bazë të kriterëve të përcaktuar me nenin 3 të këtij Udhëzimi. Sipas nenit 3, ish zyrtarët policorë kishin drejt të aplikimit për ri punësim deri në katër (4) vite pas dorëheqjes ose lirimit apo shkarkimit të tyre nga pozita e zyrtarit policor.
17. Në nëntor të vitit 2012, ishte miratuar Udhëzimi Administrativ nr. 07/2012 i Policisë së Kosovës mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, [i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës], i cili përmes nenit 88 [Ripunësimi] kishte përcaktuar që *"Zyrtari policor, i cili ka dhënë dorëheqje vullnetare, ka të drejtë për t'u ripunësuar. Megjithatë kriteri kohor për mundësinë e ripunësim për këta ish-zyrtarë policor ishte paraparë që të jetë deri në dy (2) vite nga dita e dorëheqjes. Më këtë Udhëzim Administrativ ishin shfuqizuar dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 12/2009 të cekur si më lart.*
18. Më 1 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës në Policinë e Kosovës, respektivisht ish-punëdhënësi i tij kishte parashtruar kërkesë për ripunësim duke iu referuar Udhëzimit Administrativ 12/2009, i cili kishte qenë në fuqi në kohën e dorëheqjes së tij vullnetare nga Policia e Kosovës, dhe i cili Udhëzim ishte shfuqizuar me Udhëzimin Administrativ 07/2012, të nëntorit të vitit 2012.
19. Më 13 korrik 2016, ish-Punëdhënësi i parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Policia e Kosovës përmes përgjigjes e njoftoi parashtruesin e kërkesës për refuzimin e kërkesës së tij për ripunësim.

20. Më 9 nëntor 2016, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës përmes Vendimit, 07/1-01A/0166/16 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i 9 nëntorit 2016) e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për ripunësim. Në vendimin e saj të lartcekur, Policia e Kosovës kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk plotëson kriteret e përcaktuar me nenin 90 [Kriteret kohore për ripunësim] pika 2 të Udhëzimit Administrativ 07/2012, sipas të cilës dispozitë përcaktohet që *“kandidati ish zyrtari policor i cili a qëndruar jashtë shërbimi me shumë se dy (2) vite nuk mund të ripunësohet.”* Në lidhje me këtë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës konstatoi se parashtruesi i kërkesës kishte dhënë dorëheqje vullnetare nga Policia e Kosovës më 7 shtator 2012 dhe kërkesën e tij për ripunësim e kishte parashtruar më 1 korrik 2016, përkatësisht më shumë se tri (3) vite më vonë nga data e dorëheqjes së tij.
21. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore parashtroi padi përmes të cilës kishte kërkuar (i) anulimin e Vendimit të lartcekur, të 9 nëntorit 2016 të Policisë së Kosovës dhe (ii) të obligojë Policinë e Kosovës që brenda shtatë (7) ditësh ta kthejnë në vendin e tij të mëparshëm të punës si zyrtar policor në Policinë e Kosovës.
22. Më 16 dhjetor 2016, ndaj padisë së parashtruesit të kërkesës Policia e Kosovës, në cilësinë e të paditurës kishte parashtruar përgjigje në padi. Në përgjigjen e saj ndaj padisë së parashtruesit të kërkesës, Policia e Kosovës përveç pretendimit të saj se padia ishte parashtruar jashtë afatit ligjor, ndër tjerash kishte theksuar se sipas nenit 90, pika 2 të Udhëzimit Administrativ 07/ 2012 të Policisë së Kosovës, të nëntorit të vitit 2012, zyrtari policor që ka qëndruar jashtë shërbimit policor për më shumë se dy (2) vite nuk mund të ripunësohet.
23. Më 27 mars 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit, C. Nr. 336/16 vendosi që të: (i) anulojë Vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, të 9 nëntorit 2016; detyroi Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, në cilësinë e të paditurave që brenda shtatë (7) ditësh nga dita e pranimi të Aktgjykimit të saj, t'i mundësojë parashtruesit të kërkesës që t'i nënshtrohet proceduarve të ripunësimit në pajtim me nenin 3, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2009; (iii) obligoi të paditurat për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore të parashtruesit të kërkesës.
24. Gjykata Themelore pas konstatimit të saj se padia e parashtruesit të kërkesës ishte e bazuar, dhe elaborimit dhe analizës së fakteve, si dhe dispozitave të dy Udhëzimeve të lartcekurat Administrative të Policisë së Kosovës që ndërlidhen me ripunësim në Policinë e Kosovës arriti në përfundim se në rastin e parashtruesit të kërkesës gjen zbatim ligji më i favorshëm, përkatësisht Udhëzimi Administrativ 12/2009 i cili kishte qenë në fuqi në kohën e dorëheqjes së tij vullnetare.
25. Më 24 korrik 2015, Policia e Kosovës, në cilësinë e të paditurës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
26. Më 16 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit Ac. Nr. 2830/17 vendosi që (i) aprovojë ankesën e të paditurës, gjegjësisht Policisë së Kosovës;

(ii) ndryshoi Aktgjykimin, C. Nr. 336/16 të 27 marsit 2017 të Gjykatës Themelore; dhe (iii) refuzoi si të pabazuar padinë e parashtuesit të kërkesës kundër Vendimit, të 9 nëntorit 2016.

27. Gjykata e Apelit pas konstatimit se ankesa e Policisë së Kosovës ishte e bazuar, në vijim konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk ishte i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe më vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, por ishte i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
28. Sipas Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore para se të konstante se cili Udhëzim Administrativ ishte i zbatueshëm në rastin e parashtuesit të kërkesës vlerësoi nëse e paditura [Policia e Kosovës] ka obligim ligjor që secilin ish-zyrtar i saj që aplikon për ripunësim ti mundësohet ripunësimi. Thënë këtë, Gjykata e Apelit iu referua formulimit të dy Udhëzimeve të lartcekura Administrative të Policisë së Kosovës përmes të cilave përcaktohet që *“ripunësimi është njëra nga praktikat më të mira që do të përdoret për të përmbushur nevojat e Policisë së Kosovës dhe jo si një obligim i organizatës për të ripunësuar ish zyrtarët policorë.”* Sipas kësaj të fundit, Gjykata e Apelit vlerësoi se ripunësimi nga ana e Policisë nuk është obligativ por në diskrecion të saj për të vendosur nëse e ripunëson një ish-zyrtar të saj policor. Si rezultat i këtij vlerësimi, Gjykata e Apelit konsideroi se çështja se cili Udhëzim Administrativ ishte në fuqi në rastin e parashtuesit të kërkesës është jo relevante, për arsye se sipas saj të dy Udhëzimet Administrative përmbajnë të njëjtin formulim, gjegjësisht formulimin se çështja e ripunësimit në Policinë e Kosovës përbën të drejtë fakultative për këtë të fundit dhe jo detyrim.
29. Megjithatë, Gjykata e Apelit duke theksuar se *“për hirë të praktikës gjyqësore edhe pse u tha se nuk përbën ndonjë relevancë”* vlerësoi se *“në rastin konkret udhëzimi në të cilin është bazuar e paditura [Policia e Kosovës] dhe i cili ka qenë në fuqi në kohën e aplikimit [Udhëzimi Administrativ 07/2012]] duhet të zbatohet dhe jo Udhëzimi i kaluar [Udhëzimi Administrativ 12/2009].”* Dorëheqja është bërë konform Udhëzimit që ka qenë në fuqi në kohën e aktit të dorëheqjes por riaplikimi për punësim nuk mund të bëhet konform Udhëzimit që nuk është në fuqi, por se i njëjti duhet të bazohet në Udhëzimin i cili është në fuqi në kohën e aplikimit, pasi kemi të bëjmë me themelim të një të drejte të punësimit, dhe jo vërtetim të ekzistimit të një drejte, pasi me aktin e dorëheqjes çështja e punësimit ka përfunduar, dhe tani me aplikim dhe me vetë statusin ripunësim, normal që vlen Udhëzimi në kohën e aplikimit, e jo udhëzimi i cili nuk është në fuqi.”
30. Më 12 shkurt 2020, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtuesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Parashtuesi i kërkesës në revizionin e tij, ndër tjerash theksoi se *“[...] zbatimi i gabuar i se drejtës materiale mbështetet në faktin që [atij] i është shkelur e drejta në punën e garantuar në kuptim të nenit 49, par 1 [të Kushtetutës] dhe i janë shkelur të drejtat e njeriut në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”* Parashtuesi i kërkesës, në vijim specifikoi se Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar kishte aplikuar të drejtën materiale në rastin e tij dhe në lidhje me këtë nënvizoi se

"[...] një gjë e tillë është në kundërshtim me normat ligjore dhe normat e moralit shoqërore, dhe legjislacioni në fuqi, si dhe konventat Evropiane të të drejtave të Njeriut, dhe shkeljen e statusit të barabartë qytetarë, një gjë e tillë nuk e njih as praktika gjyqësore, aplikimin e një postulati të tillë, e që ligji duhet të aplikohet atëherë që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve apo në rastin tjetër, ligji që është më i favorshëm, ndaj personit që ushtron kërkesë, apo që mundet të ketë kryer ndonjë veprim tjetër, edhe të natyrës penale, për legjislacionin në fuqi dhe praktika gjyqësore, e njohin që duhet aplikuar dispozitat ligjore, që kanë qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve procedurale, deri në kohën e shfuqizimit të Udhëzimit Administrativ, apo deri në kohën sa ka qenë ligji në fuqi, duhet aplikuar të gjitha dispozitat ligjore, apo në rastin e kundërt ligji që është më i favorshëm, duke mos e shkelur të drejtën e punës së garantuar të njohur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe të drejtën e barabarësisë qytetare."

31. Më 26 janar 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit, Rev. Nr. 138/2020 revizionin e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
32. Gjykata Supreme duke rikujtuar se marrëdhënia e punës së parashtruesit si zyrtar policor në Policinë e Kosovës kishte pushuar në momentin e dorëheqjes së tij vullnetare nga puna, konstatoi se Policia e Kosovës nuk ka asnjë obligim ligjor në raport me parashtruesin e kërkesës sa i përket marrëdhënies së tij të punës, përderisa e drejta e tij për ripunësim nuk nënkupton të drejtën e tij në punësim në Policinë e Kosovës.
33. Në vijim, Gjykata Supreme duke vërtetuar se konstatimi i Gjykatës së Apelit, për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 është i drejtë shtoi se *"pasi që më dispozitat kalimtare nën 102, të këtij udhëzimi është shfuqizuar UA 12/2009, në fuqi nga prilli 2010, për procedurat e ripunësimit për zyrtarët policorë, dhe bazuar në nenin 104, i njëjti Udhëzim është në fuqi nga data 04.08.2015 çka do të thotë se çdo kërkesë e parashtruar pas kësaj date, për realizimin e të drejtave të përcaktuara sipas këtij udhëzimi, edhe kërkesa e paditësit për ripunësim duhet të trajtohet sipas këtij udhëzimi, sepse nuk mund të aplikohen udhëzimet të cilat nuk janë në fuqi, e drejta e punësimit nuk është e drejtë e fituar, në momentin e dhënies së dorëheqjes nga Policia e Kosovës, por mundësi për të parashtruar kërkesën për ripunësim, e cila vlerësohet në momentin e paraqitjes së kërkesës, pasi edhe qëllimi i ripunësimit është për nevojat e të paditurës [Policisë së Kosovës]."*
34. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në revizion për shkelje të nenit 49 dhe 53 të Kushtetutës, Gjykata Supreme theksoi se në rastin e tij nuk janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën duke arsyetuar se garantimi i të drejtës për punësim nuk nënkupton të drejtën e secilit që dëshiron të punësohet që ti realizohet punësimi. Sipas Gjykatës Supreme e drejta e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës nënkupton që *"secili mund të zgjedhë punën dhe profesionin që dëshiron, dhe shteti është garant që kjo e drejtë nuk i kufizohet askujt, qoftë me dispozita ligjore diskriminuese, apo duke aplikuar ndalesa për kategori të caktuara, apo trajtim diskriminues, që dikujt do ti pamundësonin kryerjen e punës apo profesionin që e dëshiron."*

35. Në fund, Gjykata Supreme duke iu referuar vendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit i cili mban titullin Aktvendim dhe jo Aktgjykim, theksoi se është një gabim teknik, i cili ndonëse nuk është përmirësuar nga Gjykata Themelore, nuk ndikon në vendosjen përkitazi me ligjshmërinë e çështjes dhe se gjatë vendosjes sipas revizionit të parashtruesit të kërkesës, vendimi i Gjykatës së Apelit është trajtuar si Aktgjykim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; dhe 49 [E Drejta për Punë dhe Ushtrim të Profesionit] të Kushtetutës.
37. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se dorëheqjen e tij nga pozita e zyrtarit policor e ka dhënë nën *“garantimin ligjor të aktit të brendshëm me të cilin rregullohen marrëdhëniet brenda institucionit të Policisë së Kosovës.”* Në kontekst të kësaj, parashtruesi i kërkesës vendos theksin edhe në faktin se dorëheqjen e tij vullnetare e kishte dhënë si pasojë e sëmundjes së rëndë të vajzës së tij, e cila përkundër trajtimeve mjekësore më pas kishte ndërruar jetë.
38. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pohon se përveç se në Gjykatën Themelore, në Gjykatën e Apelit dhe atë Supreme nuk është vlerësuar drejtë parimi i zbatueshmërisë së rregullave më të favorshme. Në kuptim të kësaj të fundit, parashtruesi i kërkesës arsyeton se ai ka nënshkruar dorëheqjen vullnetare në momentin kur në fuqi ishte Udhëzimi Administrativ 12/2009, dhe i cili *“ish të punësuarve zyrtarë policorë me dorëheqjen vullnetare ua lejon kërkesën për ripunësim brenda afatit deri në 4 vite.”* Bazuar në këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pohon se kërkesa e tij për ripunësim është dashur të të trajtohej sipas Udhëzimit Administrativ i cili ishte në fuqi në momentin e dorëheqjes së tij. Në lidhje, me këtë parashtruesi i kërkesës thekson se në *“të drejtën civile parashihet analogjia e po ashtu edhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet zbatimi i ligjit më të favorshëm për palën [...]”*.

(i) Përkitazi me nenin 24 të Kushtetutës

39. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se *“jemi në njohuri se nga e paditura janë pranuar dhe pa plotësim kriteresh shumë kërkesa për ripunësim dhe sot gjenden në vendet e punës zyrtarë të caktuar.”* Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës argumenton që Udhëzimi Administrativ, si akt nënligjor duhet të zbatohet duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë zyrtarët në situata të njëjta.
40. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të “barazisë para ligjit” të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës shton se ai është diskriminuar në raport me ish-zyrtarë tjerë policorë të cilët në ndërkohe janë ripunësuar, rastet e të cilëve sipas tij ngërthenin të njëjtat rrethana faktike si ato në rastin e tij. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës në Gjykatë kishte dorëzuar kopjet e vendimeve për ripunësim të tre (3) ish-

zyrtarëve policorë, sipas të cilave këta të fundit ishin ripunësuar në Policinë e Kosovës.

41. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për shkelje të nenit 24 e mbështet duke iu referuar edhe rastit të Gjykatës KI89/13 [me parashtruese të kërkesës, *Arbresha Jonuzi*, Aktgjykim, i 12 marsit 2014]. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se Gjykata Supreme “*shkel të drejtat [e tij] duke mos aplikuar parimin kushtetues të barazisë para ligjit me Aktgjykimin e saj, i cili paraqet diskriminim të thellë në raport me vendimet që janë marrë për ri-punësim të kolegëve të tjerë [...].*”

(ii) *Përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës*

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e Gjykatës së Apelit dhe ai i Supremes i kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës ngit dy pretendime specifike, përkatësisht (i) pretendimin se Gjykata Supreme nuk ka aplikuar ligjin më të favorshëm në rastin e tij; dhe (ii) pretendimin për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe shkelje të parimit të sigurisë juridike, përkatësisht specifikon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj nuk ka adresuar pretendimet e tij të ngritura në revizionin e tij.
43. Përkitazi me të parin, parashtruesi i kërkesës më tej specifikon se është Udhëzimi Administrativ [12/2009] që ishte në fuqi në kohën e dorëheqjes së tij, i cili është dashur të zbatohet në rastin e tij.
44. Përkitazi me më të dytin, përkatësisht pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës specifikon se Gjykata Supreme nuk ka cekur dhe nuk ka adresuar pretendimet e tij të parashtruar në revizion para kësaj gjykate e që ndërlidhet me diskriminimin e tij në raport me ish-kolegët e tij, të cilët sipas tij në rrethana të njëjta ishin ripunësuar në Policinë e Kosovës. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij ka theksuar se Gjykata Supreme duke bërë “*ripërshkrim të të thënave të Gjykatës së Apelit*” ka krijuar konfuzitet dhe pasiguri përmes Aktgjykimit të saj duke ditur se arsyetimi është element i tretë përbërës i një vendimi gjyqësor në të cilin duhet të përshkruhen qartë dhe saktë të gjitha pretendimet, vlerësimet e Gjykatës dhe mbështetja ligjore për vlerësimet e saj, kjo është detyrë e secilës Gjykatë që në përpikmëri të thellë dhe precize argumentojnë qëndrimet e saj mbi pretendimet e palëve duke i mbështetur çdo her analizat dhe vlerësimet e saja konform provave të ofruara, ligjit dhe praktikës më të mirë gjyqësore”.

(iii) *Përkitazi me nenin 49 të Kushtetutës*

45. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se arsyetimi i Gjykatës Supreme në adresimin e pretendimit të tij për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës ka krijuar pasiguri juridike. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës thekson se ai duke qenë në marrëdhënie punë në Policinë e Kosovës, me “*vullnet të detyruara nga rrethanat familjare (si kujdestar ligjor dhe biologjik i vajzës së tij të sëmurë nga një sëmundje e rëndë)*

të dorëhiqet vullnetarisht dhe që në kohën e riaplikimit ky Udhëzim [12/2009] është bazë për aplikim dhe sipas tij ka zënë aftin ligjor për aplikim, pra nuk është “dikush që dëshiron të punësohet”, por vetë [...] lejimi i të drejtës për ri-aplikim i jep titull përparësi në raport me dikë që dëshiron të punësohet në një institucion apo person tjetër juridik për herë të parë me kriterë të përgjithshme.”

46. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata “[...] pas analizimit të dokumentacionit të bashkëngjitur me këtë kërkesë individuale ta miratojë si të bazuar dhe të vërtetojë se me vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës janë shkelur qartë të drejtat e [tij].”

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.
[...]

Udhëzimi Administrativ nr. 12/2009 për Procedurat e Ripunësimit për Zyrtarët Policorë, i Policisë së Kosovës
[nënshkruara nga u.d i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Prill 2010]

Neni 1
Qëllimi

1. Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim që ish zyrtarët policorë të cilët kanë dhënë dorëheqje vullnetare me qëndrim të mirë, apo janë shkarkuar apo liruar si rezultat i riorganizimit apo reduktimit të Policisë së Kosovës kanë të drejtë për t'u ripunësuar.

Neni 3
[Kriteret kohore për ripunësim]

1. Kriteret për ripunës deri në një (1) vit janë si në vijim:
 - 1.1. Parashtrimi i kërkesës
 - 1.2. Verifikimi i së kaluarës, testimi fizik dh testi mjekësor i kompletuar me sukses
 - 1.3. Kursi ricertifikues
 2. Kriteret për ripunës prej një (1) deri në dy (2) vjet, janë si në vijim
 - 2.1. Parashtrimi i kërkesës
 - 2.2. Verifikimi i së kaluarës, testimi fizik dh testi mjekësor i kompletuar me sukses
 - 2.3. Kursi ricertifikues
 - 2.4. Minimum dy (2) javë trajnim të programit fushor, të përcjellur me vlerësim të shkruar final.
 3. Kriteret për ripunës prej dy (2) deri në katër (4) vite, janë si në vijim
 - 3.1. Parashtrimi i kërkesës
 - 3.2. Verifikimi i së kaluarës, testimi fizik dh testi mjekësor i kompletuar me sukses
- [...]

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Udhëzimi Administrativ nr. 07/2012 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i Policisë së Kosovës *[i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, nëntor 2012]*

Neni 88
Ripunësimi

1. Zyrtar policor, i cili ka dhënë dorëheqje vullnetare, ka të drejtë për t'u ripunësuar.

2. *Ripunësimi është njëra nga praktikat më të mira që do të përdoret për të përmbushur nevojat e Policisë së Kosovës dhe jo si një obligim i organizatës për të punësuar zyrtarët policorë.*

Neni 89 Procedurat e ripunësimit

1. *Zyrtari policor i cili kërkon të ripunësohet duhet të aplikojë duke përdorur dokumentacionin e Policisë së Kosovës për punësim. Dokumentet për aplikim do të dorëzohen në zyrën e Rekrutimit dhe Seleksionimit në Drejtorinë e Personelit.
[...]*

Neni 90 Kriteret kohore për ripunësim

1. *Kriteret për ripunësim deri në dy (2) vite vjet, përveç zyrtarëve që kanë punuar në institucionet shëndetësore të sigurisë, janë si në vijim:*

- 1.1. *Parashtrimi i kërkesës*
- 1.2. *Verifikimi i së kaluarës, testimi fizik, testi mjekësor dhe psikologjik i kompletuar me sukses;*
- 1.3. *Kursi ricertifikues*
- 1.4. *Pas gjashtë (6) muajsh të bëhet vlerësim i performancës*

2. *Kriteret për ripunësim mbi dy (2) vite vjet janë si në vijim, përveç zyrtarëve që kanë punuar në institucionet shëndetësore të sigurisë:*

- 2.1. *Parashtrimi i kërkesës*
- 2.2. *Verifikimi i së kaluarës, testimi fizik, testi mjekësor dhe psikologjik i kompletuar me sukses;*
- 2.3. *Kursi ricertifikues*
- 2.4. *Intervistë sipas nivelit të gradës*
- 2.5. *Program i vecantë i trajnimit*
- 2.6. *Pas gjashtë (6) muajsh të bëhet vlerësim i performancës*

3. *Të gjithë kandidatë për ripunësim që me sukses kompletojnë trajnimet përkatëse do të rikthehen në pozitën e mëparshme apo ekuivalente si zyrtarë policorë dhe do t'iu jepen të gjitha pajisjet e nevojshme.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- 47. *Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.*
- 48. *Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:*

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

49. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individë mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

50. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin Rev. Nr.138/2020, të 21 janarit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
51. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në këtë aspekt, Gjykata do t'u referohet rregullave relevante të Rregullores së punës, si në vijim:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,

(...)

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

52. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, përkatësisht kriterin që kërkesa ose një pretendim që ngërthen e njëjta, të mos jetë qartazi e pabazuar, në mënyrë që të shpallet e pranueshme. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

53. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”* të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021).
54. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me dorëheqjen vullnetare të parashtuesit të kërkesës nga pozita e zyrtarit policor në Policinë e Kosovës, të paraqitur më 9 shtator 2012. Në vitin 2016, përkatësisht pa u mbushur katër (4) vite nga dorëheqja e tij vullnetare, parashtuesi i kërkesës kishte parashtuar kërkesë për ripunësim në Policinë e Kosovës, të cilën kërkesë e kishte bazuar në dispozita e Udhëzimit

Administrativ 12/2009, i cili kishte qenë në fuqi në kohën e dorëheqjes së tij. Policia e Kosovës, më 13 korrik 2016 kishte refuzuar kërkesën e tij. Si rezultat i ankesës së tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, kjo e fundit përmes Vendimit, të saj të 9 nëntorit 2016 refuzoi ankesën e tij duke konstatuar se sipas Udhëzimit Administrativ 07/2012, i cili ishte në fuqi në momentin e aplikimit të parashtruesit të kërkesës për ripunësim, ky i fundit nuk e plotëson kriterin e afatit kohor, përkatësisht ka parashtruar kërkesën e tij jashtë afatit të përcaktuar kohor që është i paraparë të jetë deri në (2) vjet nga dita e dorëheqjes vullnetare. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore kishte parashtruar padi me kërkesë (i) për anulim, të Vendimit, të 9 nëntorit 2016 të Policisë së Kosovës dhe (ii) kthimin në vendin e tij të mëparshëm të punës si zyrtar policor në Policinë e Kosovës. Gjykata Themelore, kishte aprovuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe kishte vendosur që (i) të anulojë Vendimin, e 9 nëntorit 2016 të Policisë së Kosovës dhe (ii) të obligojë Policinë e Kosovës që brenda shtatë (7) ditësh parashtruesi i kërkesës ti nënshtrohet procedurës së ripunësimit ashtu siç është paraparë me dispozitat e Udhëzimit 12/2009, Udhëzim ky që kishte qenë në fuqi në kohën e dhënies së dorëheqjes së tij vullnetare nga Policia e Kosovës. Si rezultat i ankesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, të parashtruar nga Policia e Kosovës në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit kishte aprovuar ankesën e Policisë së Kosovës duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe vendosur që padia e parashtruesit të kërkesës të refuzohej si e pabazuar. Gjykata e Apelit, ndër tjerash kishte konstatuar se është në (i) diskrecionin e punëdhënësit, që të vendosë përkitazi me ripunësimin e parashtruesit të kërkesës, pasi që kjo e drejtë që përcaktohet përmes dy Udhëzimeve të Policisë, nuk nënkupton të drejtë të fituar për ripunësim, përkatësisht obligim për Policinë e Kosovës që ta ri punësojë parashtruesin e kërkesës në pozitën e zyrtarit policor; (ii) përkitazi me çështjen se cili nga dy Udhëzimet Administrative është i zbatueshëm në rastin e tij kishte konstatuar se në rastin e parashtruesit të kërkesës Udhëzimi i zbatueshëm është Udhëzimi Administrativ 07/2012, i cili ishte në fuqi kur parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën për ripunësim në Policinë e Kosovës. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të [Rev. Nr. 138/2020] të 26 janarit 2021 revizionin e parashtruesit të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar. Përmes Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme duke vërtetuar qëndrimin dhe konstatimin e dhënë nga Gjykata e Apelit kishte konstatuar se në rastin e tij nuk gjen zbatim Udhëzimi Administrativ 12/2009 por Udhëzimi Administrativ 07/2012, i cili kishte qenë në fuqi në momentin kur parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për ripunësim në Policinë e Kosovës.

55. Parashtruesi i kërkesës i konteston këto konstatime të Gjykatës Supreme para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës.

I. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

56. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të “barazisë para ligjit” të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës pretendon se ai është diskriminuar në raport me ish-zyrtarë tjerë policorë të cilët në ndërkohe janë ripunësuar, rastet e të cilëve sipas tij ngërthenin të njëjtat rrethana faktike si ato në rastin e tij. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtuesi i kërkesës në Gjykatë kishte dorëzuar kopjet e vendimeve për ripunësim të tre (3) ish-zyrtarëve policorë, sipas të cilave këta të fundit ishin ripunësuar në Policinë e Kosovës: Vendimin për Ripunësim të Policisë së Kosovës, të 18 dhjetorit 2014 përkitazi me ripunësimin e E.L; Vendimin për Ripunësim të Policisë së Kosovës, të 8 dhjetorit 2011 përkitazi me ripunësimin e M.B; Vendimin për Ripunësim të Policisë së Kosovës, 12 shtatorit 2014 përkitazi me ripunësimin e B.T.
57. Në vijim, të kësaj Gjykata vëren se: (i) Vendimi për Ripunësim i Policisë së Kosovës, i 18 dhjetorit 2014 përkitazi me ripunësimin e E.L mbështetet në Udhëzimin Administrativ 07/2012; (ii) Vendimi për Ripunësim i Policisë së Kosovës, i 8 dhjetorit 2011 përkitazi me ripunësimin e M.B mbështetet në Udhëzimin Administrativ 12/2009; dhe (iii) Vendimi për Ripunësim i Policisë së Kosovës, i 12 shtatorit 2014 përkitazi me ripunësimin e B.T. mbështetet në Udhëzimin Administrativ 07/2012.
58. Në vijim, parashtuesi i kërkesës pretendimin e tij për shkelje të nenit 24 e mbështet duke iu referuar edhe rastit të Gjykatës KI89/13 [me parashtuese të kërkesës, *Arbresha Jonuzi*, Aktgjykim, i 12 marsit 2014]. Në lidhje me këtë, parashtuesi i kërkesës specifikon se Gjykata Supreme “shkel të drejtat [e tij] duke mos aplikuar parimin kushtetues të barazisë para ligjit me Aktgjykimin e saj, i cili paraqet diskriminim të thellë në raport me vendimet që janë marrë për ri punësim të kolegëve të tjerë [...]”.
59. Në kontekst të këtyre lartcekurave, Gjykata duke u bazuar në revizionin e parashtuar nga parashtuesi i kërkesës në Gjykatën Supreme megjithatë vëren se ky i fundit kishte pretenduar zbatim të gabuar të drejtës materiale, duke specifikuar se si rezultat i aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht aplikueshmërisë së Udhëzimit Administrativ 07/2012 që ishte në fuqi në kohën e aplikimit të tij për ripunësim në Policinë e Kosovës është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.
60. Thënë këtë, Gjykata bazuar në përmbajtjen e revizionit gjen se parashtuesi i kërkesës një pretendim specifik se është diskriminuar në raport me ish-kolegët e tij që sipas tij në rrethana të ngjashme janë ripunësuar në Policinë e Kosovës, ashtu siç e ka specifikuar në kërkesën e tij para Gjykatës Kushtetuese, nuk e kishte ngritur në revizionin e tij të parashtuar në Gjykatën Supreme.
61. Në një kontekst të tillë, kur pretendimet e parashtuesit të kërkesës as formalisht por as në substancë/përmbajtje nuk janë ngritur para gjykatave të rregullta, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial, dhe

rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta, ndër të tjera, edhe në rastet e Gjykatës, KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 71; KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019 paragrafi 92; KI155/18, parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50; KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 59, dhe KI239/19, parashtrues *Hakif Veliu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 shkurtit 2021, paragrafi 149).

62. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "substance" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet (shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, KI71/18, parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi* cituar më lart, paragrafin 73; rastin KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"* cituar më lart, paragrafi 94; rastin KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, cituar më lart, paragrafi 61; dhe rastin KI239/19, parashtrues *Hakif Veliu*, cituar më lart, paragrafi 150).
63. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë. (Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, cituar më lart, paragrafi 93; rastin KI155/18, me parashtrues *Benson Buza*, të cituar më lart, paragrafi 49; rastin KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, të cituar më lart, paragrafi 60).

64. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se ky pretendim specifik i parashtruesit të kërkesës është ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KI05/18, të cituar më lart, paragrafi 95; dhe rastin KI163/18, të cituar më lart, paragrafi 62).
65. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se ky pretendim duhet të refuzohet si i papranueshëm për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores se punës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

66. Për sa i përket pretendimeve që kanë të bëjnë me nenin 31 të Kushtetutës, Gjykata vëren se (i) parashtruesi i kërkesës pretendon mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, përkatësisht Aktgjykimin të Gjykatës Supreme si rezultat i mosadresimit të pretendimeve të tija thelbësore të parashtruara në revizion e që i referohet pretendimit të tij se është Udhëzimi Administrativ 12/2009 i zbatueshëm në rastin e tij dhe (ii) Gjykata Supreme nuk ka zbatuar ligjin më të favorshëm në rastin e tij, respektivisht Udhëzimin Administrativ 12/2009.

(i) Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor

67. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme duke pretenduar mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, si rezultat i mosadresimit të pretendimit të tij thelbësor të ngritur në revizionin e tij.
68. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi, Gjykata fillimisht do t'i shtjellojë shkurtimisht parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor të vendosura përmes praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës; dhe me pas, do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.
69. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27

shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

70. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
71. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).
72. Gjykata përsëritë se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ka adresuar pretendimin e tij thelbësor të ngritur në kërkesën e tij për revizion, përkatësisht pretendimin e tij që ndërlidhet me çështjen e zbatueshmërisë së Udhëzimit Administrativ 12/2009 si ligj më i favorshëm në rastin e tij.

73. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të saj përkitazi me çështjen e zbatueshmërisë kishte vlerësuar *“në rastin konkret udhëzimi në të cilin është bazuar e paditura [Policia e Kosovës] dhe i cili ka qenë në fuqi në kohën e aplikimit [Udhëzimi Administrativ 07/2012]] duhet të zbatohet dhe jo Udhëzimi i kaluar [Udhëzimi Administrativ 12/2009].”* Dorëheqja është bërë konform Udhëzimit që ka qenë në fuqi në kohën e aktit të dorëheqjes por riaplikimi për punësim nuk mund të bëhet konform Udhëzimit që nuk është në fuqi, por se i njëjti duhet të bazohet në Udhëzimin i cili është në fuqi në kohën e aplikimit, pasi kemi të bëjmë me themelimin të një të drejte të punësimit, dhe jo vërtetim të ekzistimit të një drejte, pasi me aktin e dorëheqjes çështja e punësimit ka përfunduar, dhe tani me aplikim dhe me vetë statusin ripunësim, normal që vlen Udhëzimi në kohën e aplikimit, e jo udhëzimi i cili nuk është në fuqi.”
74. Në vijim, Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një vendim të arsyetuar gjyqësor e të shtjelluara më lart, rikujton se në adresimin e pretendimeve të parashtruesve përkatës, gjykatat e rregullta, janë të detyruara që të japin përgjigje, ndër të tjera, lidhur me ato pretendime të cilat janë thelbësore ose përcaktuese për rrethanat e një rastit.
75. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në revizionin e tij kishte pretenduar zbatim të gabuar të drejtës materiale duke pretenduar se Gjykata e Apelit nuk e kishte zbatuar Udhëzimin Administrativ 12/2009 si ligj më të favorshëm në rastin e tij. Në lidhje me këtë dhe bazuar në arsyetimin e dhënë të Gjykatës Supreme, të dhënë përmes Aktgjykimit të saj, Gjykata konsideron se kjo e fundit ka adresuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës të ngritur në revizionin e tij kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Thënë këtë, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme kishte konstatuar se *“pasi që më dispozitat kalimtare nenin 102, të këtij udhëzimi është shfuqizuar UA 12/2009, në fuqi nga prilli 2010, për procedurat e ripunësimit për zyrtarët policorë, dhe bazuar në nenin 104, i njëjti Udhëzim është në fuqi nga data 04.08.2015 çka do të thotë se çdo kërkesë e parashtruar pas kësaj date, për realizmin e të drejtave të përcaktuara sipas këtij udhëzimi, edhe kërkesa e paditësit për ripunësim duhet të trajtohet sipas këtij udhëzimi, sepse nuk mund të aplikohen udhëzimet të cilat nuk janë në fuqi, e drejta e punësimit nuk është e drejtë e fituar, në momentin e dhënies së dorëheqjes nga Policia e Kosovës, por mundësi për të parashtruar kërkesën për ripunësim, e cila vlerësohet në momentin e paraqitjes së kërkesës, pasi edhe qëllimi i ripunësimit është për nevojat e të paditurës [Policisë së Kosovës].”*
76. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

(ii) *Përkitazi me pretendimin e parashtruesit se Gjykata Supreme nuk ka zbatuar ligjin më të favorshëm në rastin e tij*

77. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj nuk ka zbatuar ligjin më të favorshëm në rastin e tij, përkatësisht Udhëzimin Administrativ 12/2009.
78. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht thekson se, si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe, si të tilla, parimisht, nuk janë çështje të Gjykatës Kushtetuese (shih rastet nr. KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues *X*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
79. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me mënyrën se si gjykatat e rregullta bëjnë konstatimin e fakteve ose interpretimin e ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato (gjykatat e rregullta) mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë arsyet faktike dhe ligjore që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim, në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata Kushtetuese do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Pra, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
80. Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës KI75/17, me parashtrues *X*, të cituar më lart, paragrafi 59).
81. Prandaj, duke u bazuar në përmbajtjen e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet e tij për zbatim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
82. Duke iu referuar procedurave të zhvilluara në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se pas Vendimit të 9 nëntorit 2016 të Policisë së Kosovës, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore.
83. Gjykata Themelore kishte aprovuar padinë e tij duke konstatuar se Udhëzimi, i cili është i zbatueshëm në rastin e tij është Udhëzimi Administrativ 12/2009, i cili ishte në fuqi në kohën e dhënies së dorëheqjes vullnetare nga ana e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, një qëndrim dhe konstatim të tillë nuk

ishite aprovuar nga ana e Gjykatës së Apelit dhe e Gjykatës Supreme, respektivisht.

84. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike konteston aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, përmes së cilave ishte konstatuar se Udhëzimi i cili është i zbatueshëm në rastin e parashtruesit të kërkesës është Udhëzimi Administrativ 07/2012, i cili kishte qenë në fuqi në kohën e parashtrimin të kërkesës të parashtruesit të kërkesës për ripunësim në Policinë e Kosovës, respektivisht më 1 korrik 2016.
85. Në vijim, Gjykata si më sipër ka rikujtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme përkitazi me zbatimin e Udhëzimit Administrativ 07/2012 në rrethanat e rastit të tij. Këto dy gjykata, në veçanti ajo Supreme në thelb ka vlerësuar se marrëdhëniet e punës së parashtruesit si zyrtar policor në Policinë e Kosovës kishte pushuar në momentin e dorëheqjes së tij vullnetare nga puna, dhe për pasojë konstatoi se Polica e Kosovës nuk ka asnjë obligim ligjor në raport me parashtruesin e kërkesës sa i përket marrëdhënies së tij të punës, përderisa e drejta e tij për ripunësim nuk nënkupton të drejtën e tij në punësim në Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Gjykata Supreme kishte konkluduar se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për ripunësim duhet të trajtohet sipas Udhëzimit Administrativ 07/2012.
86. Megjithatë, duke marrë për bazë atë që është cekur më lartë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si këto interpretime të dispozitave përkatëse ligjore, të bëra nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta, kanë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme, për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe të kenë qenë arbitrare.
87. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, në mënyrë të gabuar ka interpretuar dhe zbatuar aktet nënligjorë të Policisë së Kosovës në fuqi bien në kategorinë e pretendimeve “*të shkallës së katërt*”, sepse ngërthejnë çështje që ndërlidhen me vërtetimin e gjendjes faktike dhe interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht “*ligjshmërisë*” dhe jo “*kushtetutshmërisë*”.
88. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për zbatim të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, përkatësisht Aktgjykimin të kontestuar të Gjykatës Supreme përmes të cilit ishte vërtetuar interpretimi dhe konstatimi i Gjykatës së Apelit dhe, rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

III. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës

89. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme atij i është mohuar e drejta e tij në punë dhe ushtrimin të profesionit, e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.
90. Në vijim të kësaj, Gjykata se pretendimin për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur edhe në revizionin e tij të parashtruar në Gjykatën Supreme. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se garantimi i të drejtës për punësim nuk nënkupton të drejtën e secilit që dëshiron të punësohet që ti realizohet punësimi. Sipas Gjykatës Supreme e drejta e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës nënkupton që *“secili mund të zgjedhë punën dhe profesionin që dëshiron, dhe shteti është garant që kjo e drejtë nuk i kufizohet askujt, qofte me dispozita ligjore diskriminuese, apo duke aplikuar ndalesa për kategori të caktuara, apo trajtim diskriminues, që dikujt do ti pamundësonin kryerjen e punës apo profesionin që e dëshiron.”*
91. Në sfondin e këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje praktikën e saj ku është sqaruar se Kushtetuta përkufizon një standard që ngërthen garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimin të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime të dhunshme. Këto të drejta janë të rregulluara në mënyrë më specifike me ligjet e aplikueshme (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI46/15, me parashtruese Zejna Qosaj, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2015, paragrafi 26; KI70/17, parashtrues Rrahim Ramadani, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 majit 2018, paragrafi 48; dhe KI115/19, parashtruese Sadete Jusufi, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2019, paragrafi 65).
92. Gjykata thekson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës në punë duhet kuptuar në dritën e interpretimit të mësipërm. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, në rastin konkret, argumenton se atij i është cenuar e drejta në punë dhe ushtrim të profesionit, sipas kuptimit të nenit 49 të Kushtetutës.
93. Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që do të arsyetonte konstatimin se janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimi i tij për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.
94. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse pretendimet e tij:

- I. Përkitazi me nenin 24 të Kushtetutës është i papranueshëm për shkak të mosshterimit substancial, ashtu siç është përcaktuar me nenin 113, paragrafin 7 të Kushtetutës, nenin 47 dhe Rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së Punës;
- II. Përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës e që ndërlihem me (i) mosarsyetim të vendimit gjyqësor është i qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në mungesë evidente ose të dukshme të shkeljes; dhe (ii) moszbatim të ligjit më të favorshëm në rastin e tij bien në kategorinë e pretendimeve të “shkallës së katërt” dhe rrjedhimisht është i qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës; dhe
- III. Përkitazi me nenin 49 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (b) dhe (d) dhe (2), 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani